


RRJETI

PROPAGANDISTIK RUS

PRAVDA

DHE BALLKANI



Impressum

Publikues: hibrid.info

Autor: Festim Rizanaj

Qershor 2025

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

HYRJE

Ky raport paraqet gjetjet kryesore të një hulumtimi mbi një rrjet të madh propagandistik dhe dezinformues, të njohur si “Pravda”. Ky rrjet përbëhet nga faqe të internetit që ngjajnë me portale lajmesh dhe janë të ndërlidhura mes vete. Ato mund të ndahen në tre grupe kryesore: të ndërtuara sipas kriterëve vizuale (pamjes grafike të faqeve), kohore (datës së krijimit të faqeve) dhe territoriale (vendeve të synuara). Raporti fokusohet në mënyrën e veprimtarisë së këtij rrjeti në rajonin e Ballkanit dhe hapësirat ku flitet shqip.

Raporti tregon se si rrjeti “Pravda”, përmes përmbajtjeve të pabazuara në burime të besueshme, synon të ndikojë në opinionin publik duke përhapur narrativa pro-ruse dhe pro-serbe. Metodologjia ka përfshirë analizën e raporteve të mëhershme ndërkombëtare dhe rajonale që ndriçojnë strukturën funksionale të rrjetit “Pravda”, burimet e tij, strategjitë e shpërndarjes dhe nyjet kyçe të ndikimit brenda Ballkanit.

Një vëmendje e veçantë gjatë hulumtimit i është kushtuar portalit në gjuhën shqipe albania.news-pravda.com, i cili përcjell përmbajtje që përputhen me narrativat ndërkombëtare pro-ruse dhe synimin për audiencë shqiptare më të gjerë. Janë analizuar mbi 1 mijë artikuj të publikuar në gjuhën shqipe në këtë portal, gjatë periudhës 28 mars 2024 – 28 prill 2025, me qëllim identifikimin e temave dominuese dhe narrativave të përsëritura. Analiza tregon se temat dhe narrativat kryesore janë të fokusuar në një këndvështrim pro-rus dhe pro-serb. Sipas analizës, artikujt janë kritikë ndaj NATO-s, Bashkimit Evropian (BE), Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe politikave perëndimore, veçanërisht në lidhje me Ballkanin dhe pavarësinë e Kosovës, që paraqitet si burim konflikti dhe padrejtësie. Sipas analizës, Rusia portretizohet si aleate dhe mbrojtëse e vlerave tradicionale dhe ligjit ndërkombëtar, ndërsa historia, sidomos Lufta e Dytë Botërore dhe bombardimet e Jugosllavisë, përdoren për të forcuar narrativën.

1. RRJETI “PRAVDA”

Rrjeti “Pravda” është një operacion online i koordinuar propagandistik pro-rus, i lidhur me Kremlinin, që shpërndan dezinformata përmes faqeve të internetit (domain-e dhe nëndomain-e) të maskuara si media lokale. Qëllimi i tij është të ndikojë opinionin publik global duke manipuluar burime të hapura si Wikipedia, mediat (rrjetet) sociale dhe algoritmet e inteligjencës artificiale.[1]

Ky rrjet nisi rreth viteve 2013–2014 në Krime dhe Ukrainën lindore, ku faqet e para u shfaqën si portale “agreguese lajmesh” që kopjonin materiale për konfliktin ruso-ukrainas. Shembulli i parë i njohur, i quajtur Portal Kombat, përfshinte dhjetëra faqe me emra lokalë, si crimea-news.com, që vepronin të gjitha sipas një modeli të përbashkët. [2]

1.1. Mënyra e funksionimit të rrjetit “Pravda”

Mes shtatorit dhe dhjetorit 2023, u identifikuan 193 domain-e të rrjetit pro-rus që shpërndanin përmbajtje propagandistike për audiencën ndërkombëtare. Fillimisht i fokusuar në Rusi dhe Ukrainë, rrjeti më pas synoi territoret e okupuara dhe vendet perëndimore që mbështesin Kievin. [5]

Themeluesi i rrjetit, Yevgeny Shevchenko nga Krimea, nisi aktivitetin e tij në vitin 2011 me faqen Crimea News, ndërsa faqet tjera u krijuan nga kompania e tij TigerWeb. Rrjeti u zgjerua me qindra portale automatike që përhapin përmbajtje të përkthyer ose të ripostuar nga media ruse dhe kanale Telegram, me synimin për të zgjeruar ndikimin dhe shmangur sanksionet.[3]

Rrjeti u zbulua fillimisht nga agjencia franceze VIGINUM [4], e specializuar për monitorimin e propagandës së huaj. Që nga viti 2023, ky rrjet u ribrendua dhe u zgjerua në formatin “pravda-XX.com” për vende të ndryshme, duke arritur të përfshijë, deri në pranverën e vitit 2024, mbi 200 faqe që rishpërndanin materiale pro-Kremlinit, pa krijuar përmbajtje origjinale.”

Këto domain-e nuk krijojnë përmbajtje origjinale, por ripostojnë materiale nga burime pro-Kremlinit si Telegram dhe media shtetërore ruse. Qëllimi është përhapja e narrativave që justifikojnë agresionin rus dhe diskreditojnë Ukrainën. Rrjeti përdor automatizim dhe optimizim për motorët e kërkimit për të rritur ndikimin.

[1] <https://edmo.eu/publications/russian-disinformation-network-pravda-grew-bigger-in-the-eu-even-after-its-uncovering/#:~:text=This%20indicates%20that%20the%20Pravda,is%20poor%20in%20some%20languages>

[2] Russia’s so-called “Pravda” network expands worldwide. <https://dfrlab.org/2025/02/24/russia-pravda-network-expands-worldwide/>

[3] Po aty.

[4] PORTAL KOMBAT: A structured and coordinated pro-Russian propaganda network. VIGINUM.


https://www.sgdsn.gov.fr/files/files/20240212_NP_SGDSN_VIGINUM_PORTAL-KOMBAT-NETWORK_ENG_VF.pdf

[5] Po aty

Sipas raportit të American Sunlight Project (ASP), rrjeti "Pravda" ka kaluar në 4 faza zhvillimi përmes ndryshimeve të vazhdueshme të domain-eve dhe nëndomain-eve që përdor.

Ndryshimet e domain-eve dhe nëndomain-eve në rrjetin "Pravda" janë bërë për ta centralizuar dhe automatizuar përmbajtjen dhe përkthimet. Shtimi i opsionit të gjuhës angleze ka rritur masivisht përmbajtjen, me artikuj identikë që shfaqen në shumë nëndomain-e, duke përdorur strategjinë e lokalizimit [8] për të shënjestruar audiencat ndërkombëtare.

Përdorimi i gjuhës angleze ka rritur ndjeshëm prodhimin e përmbajtjes dhe dukshmërinë e propagandës pro-ruse. Kjo qasje rrit mundësitë e shpërndarjes dhe përdorimit të artikujve nga përdorues dhe algoritme automatike, duke zgjeruar ndikimin e rrjetit përmes nëndomain-eve të reja dhe shumëfishimit gjuhësor.[9]



[8] <https://mailchimp.com/resources/website-localization/>

[9] A Pro-Russia Content Network Foreshadows the Automated Future of Info Ops. American Sunlight Project (ASP). [The Pravda Ecosystem: An Analysis of the Kremlin’s Regional Disinformation Strategy. CIDC-Sensika Disinformation Observatory](#).

Struktura operationale e rrjetit "Pravda" sipas raportit të CIDC-Sensika Disinformation Observatory: [6]

Shpërndarje e automatizuar	Faqet ripostojnë përmbajtje nga burime ruse, rrjete sociale dhe Telegram, pa krijuar përmbajtje origjinale.
Përmbajtje shumëgjuhëshe	Përmbajtja përkthehet sistematikisht për të depërtuar në tregje jo-ruse dhe për të shmangur sanksionet.
Zgjerim global	Rrjeti ka shtrirje në mbi 83 vende, me fokus në shtetet ish-sovjetike, Ballkan dhe vendet frankofone të Afrikës Perëndimore.
Infrastrukturë teknike e unifikuar	Përdoren sisteme të standardizuara që krijojnë përshtypjen e portaleve të pavarura, por kontrollohen në mënyrë të koordinuar.
Lidhje me qeverinë ruse	Analizat e DFRLab e lidhin rrjetin me kompaninë TigerWeb që ka lidhje me autoritetet ruse të pushtimit dhe rrethin e ngushtë të Putinit.

Tre qëllimet kryesore të rrjetit të lidhur me "Pravda", sipas analizës së American Sunlight Project (ASP), janë: [7]:



Manipulimi i inteligjencës artificiale përmes "LLM grooming", që synon të ndikojë në sistemet AI duke përhapur përmbajtje në mënyrë që të bëhet pjesë e trajnimeve dhe rezultateve të tyre, duke përdorur teknika si SEO dhe scraping.



Saturimi masiv i përmbajtjes pro-Rusi, që synon rritjen e dukshmërisë së narrativave përmes përhapjes së tyre në platforma të ndryshme dhe referencave të vazhdueshme.



Shfrytëzimi i efektit të "iluzionit të së vërtetës", për të bërë që përdoruesit të besojnë më lehtë në narrativa të rreme, për shkak të ekspozimit të shpeshtë ndaj tyre.

[6] The Pravda Ecosystem: An Analysis of the Kremlin's Regional Disinformation Strategy. CIDC-Sensika Disinformation Observatory).

[7] A Pro-Russia Content Network Foreshadows the Automated Future of Info Ops. American Sunlight Project (ASP). <https://static1.squarespace.com/static/6612cbdfd9a9ce56ef931004/t/67bf1de6429a912e3cbe8c83/1740578284208/PK+Report.pdf>

2. “PRAVDA” NË BALLKAN

Ballkani është bërë një nga objektivat kryesorë të fushatave dezinformuese të sponsorizuara nga Rusia dhe rrjetet e saj propagandistike. [10] Ky rajon, me histori të ndërlikuar politike dhe sfida demokratike, ofron një mjedis të përshtatshëm për përhapjen e narrativave që dëmtojnë kohezionin euroatlantik dhe besimin në institucionet demokratike. Në këtë sfond, rrjeti “Pravda” ka luajtur rol aktiv përmes shpërndarjes së përmbajtjeve të dizajnuara për të ndikuar orientimin gjeopolitik të popullatës së rajonit.

Përkundër faktit se Ballkani përfaqëson vetëm 3.2% të popullsisë globale, ai ka marrë 16.2% të përmbajtjes së rrjetit Pravda – dëshmi se rajoni trajtohet si objektiv i veçantë. [11] Sipas një hulumtimi të Radio Evropa e Lirë (REL) [12], domaine-t (web faqet) në gjuhën serbe, boshnjake, maqedonase dhe shqipe ndjekin të njëjtin format dhe ripublikojnë fjalë për fjalë përmbajtje pro-ruse. Ky rrjet funksionon si një mekanizëm i automatizuar dhe i koordinuar, pa ndërhyrje njerëzore të dukshme, që përhap mesazhe të njëtrajtshme në disa gjuhë dhe vende, duke vepruar si një dhomë jehone për propagandën ruse.

Rrjeti dezinformues “Pravda” ka synuar me intensitet të lartë vende të ish-Bashkimit Sovjetik dhe të Ballkanit, veçanërisht Serbinë dhe Bullgarinë. Sipas një analize, Serbia renditet e katërta në botë për nga numri i publikimeve për person, me një intensitet 10.1 herë më të lartë se mesatarja globale. Kjo tregon një përpjekje të drejtuar për të ndikuar perceptimet dhe opinionin publik në vende me lidhje historike ose politike me Rusinë, duke përdorur lajme të rreme dhe manipulim të informacionit.

Rajoni	% e artikujve	% e popullsisë globale
Ish-BRSS	35.80%	~5.8%
Ballkani	16.20%	~3.2%
Europa Qendrore	17.40%	~8.1%
Europa Perëndimore	21.30%	~43.7%
Azia	7.10%	~36.4%
Të tjerat	2.20%	~2.8%

[10] Rizanaj, F. & Zeneli, A: Krahasimi Ukrainë-Kosovë në narrativat dezinformuese të Rusisë. [hibrid.info](https://hibrid.info/krahasimi-ukraine-kosove-ne-narrativat-dezinformuese-te-rusise/)
<https://hibrid.info/krahasimi-ukraine-kosove-ne-narrativat-dezinformuese-te-rusise/>

[11] The Pravda Ecosystem: An Analysis of the Kremlin’s Regional Disinformation Strategy. CIDC-Sensika Disinformation Observatory). <https://www.aubg.edu/aubg-today/disinformation-observatory-report-the-data-behind-russian-pravda-disinformation-network/?region=balkan>

[12] The Pravda Ecosystem: An Analysis of the Kremlin’s Regional Disinformation Strategy. CIDC-Sensika Disinformation Observatory). <https://www.aubg.edu/aubg-today/disinformation-observatory-report-the-data-behind-russian-pravda-disinformation-network/?region=balkan>

2.1. Arkitektura e “Pravda” në Ballkan

Arkitektura e domain-eve të rrjetit dezinformues “Pravda” në Ballkan është ndërtuar në mënyrë të planifikuar dhe të ndarë në katër faza zhvillimi. Fillimisht, përdoren domain-e bazë si “pravda-xx.com” për çdo shtet (pravda-al.com), më pas kalojnë në formate më të avancuara si “xx.news-pravda.com” (al.news-pravda.com) dhe në një fazë të tretë, krijohen adresa më të personalizuara si “albania.news-pravda.com”. Faza e katërt,

synon zgjerimin e mëtejshëm të ndikimit përmes strukturave të reja domain-esh por ende nuk është implementuar për shtetet e tjera të Ballkanit.

Faqja e parë në serbisht, pravda-rs.com, u regjistrua më 20 mars 2024, dhe brenda pak ditësh – me një diferencë prej sekondash – u krijuan edhe versionet në gjuhën boshnjake, maqedonase dhe shqipe, duke dëshmuar një veprim të koordinuar dhe të automatizuar. [13]

Faza / Kodi	Shqipëri	Bosnjë & Hercegovinë	Maqedonia e Veriut	Serbi	Mali i Zi	Republika Srpska
Faza 1 – pravda-xx.com	pravda-al.com	pravda-ba.com	pravda-mk.com	pravda-rs.com	N/A	N/A
Faza 2 – xx.news-pravda.com	al.news-pravda.com	ba.news-pravda.com	mk.news-pravda.com	rs.news-pravda.com	N/A	N/A
Faza 3 – keyword.news-pravda.com	albania.news-pravda.com	bosnia-hercegovina.news-pravda.com	north-macedonia.news-pravda.com	serbia.news-pravda.com	montenegro.news-pravda.com	srpska.news-pravda.com
Faza 4 – yy-xx.news-pravda.com	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Të dhënat të DFR Lab [14], tregojnë për intensitet të ndryshëm të publikimeve në ueb-faqet e rrjetit Pravda në rajonet e Ballkanit. Gjatë vetëm 10 ditëve (nga 28 prilli deri më 8 maj 2025), faqja në gjuhën serbe (serbia.news-pravda.com) publikoi 5,334 artikuj, faqja për Malin e Zi 167 artikuj, ndërsa ajo me fokus në Ballkanin e gjerë 3,658 artikuj. Krahas kësaj, disa faqe kanë qenë aktive për një periudhë njëvjeçare


(maj 2024 – maj 2025), si ajo në shqip (2,745 artikuj), në gjuhën boshnjake (12,812 artikuj) dhe maqedonase (3,424 artikuj). Ndërkohë, faqja për Republikën Srpska publikoi 1,721 artikuj për një periudhë katërmujore, nga janari deri në maj 2025. Këto të dhëna dëshmojnë për një përpjekje të qëndrueshme dhe të koordinuar të shpërndarjes së përmbajtjes pro-Kremlinit në gjuhë dhe rajone të ndryshme të Ballkanit.

[13] How Russia Spreads Fake News In The Balkans. <https://www.rferl.org/a/russian-fake-news-disinformation-balkans/33126528.html> (shtator 2024)

[14] <https://portal-kombat.com/>

Sipas një hulumtimi të REL, gjatë periudhës nga 22 marsi deri më 20 korrik – që përfshin fazën fillestare të krijimit të rrjetit – katër ueb-faqet e "Pravda"-s (shqip, serbisht, maqedonisht dhe boshnjakisht) publikuan mbi 70 mijë lajme, kryesisht në gjuhën serbe dhe të bazuara në përmbajtje nga kanale pro-Kremlinit në Telegram. Ky rrjet funksionon me një nivel të lartë automatizimi, duke e shpërndarë përmbajtjen brenda 3 deri në 12 minuta nga publikimi fillestar, përmes platformave si VK Video dhe Yandex.[15]

Domain



Ekziston edhe domain-i balkan.news-pravda.com, që përbën një hallkë kyçe të rrjetit të dezinformimit në Ballkan. Ky domain ka një ritëm të lartë publikimi, me një mesatare prej 200–250 artikujsh në ditë, kryesisht në gjuhën serbe. Nga këto të dhëna rezultojnë se është aplikuar një strategji që kombinon mbulimin global me një përqendrim të veçantë në Serbi, ku rajoni përdoret si kanal për shpërndarjen e narrativave pro-ruse. Në aspektin e burimeve, përmbajtja e portalit dominohet nga dy platforma mediatike të lidhura me shtetin rus: lat.rt.rs (RT në versionin latin për Serbinë) dhe lat.sputnikportal.rs (Sputnik në versionin latin), të cilat kontribuojnë me shumicën dërrmuese të artikujve.




[15] How Russia Spreads Fake News In The Balkans. <https://www.rferl.org/a/russian-fake-news-disinformation-balkans/33126528.html> (shtator 2024).

3. "PRAVDA" NË SHQIP

"Pravda" në shqip përfaqëson një pjesë të rëndësishme të rrjetit të faqeve të dezinformimit të lidhura me platformën "Pravda". Arkitektura e domain-eve të përdorura për këtë platformë është e strukturuar në disa faza, duke përfshirë

domenë si "pravda-al.com", "al.news-pravda.com" dhe "albania.news-pravda.com", që pasqyrojnë zhvillimin dhe adaptimin e përmbajtjes për audiencën shqiptare.



3.1. Domain-i në shqip "albania.news-pravda.com"

Faqja albania.news-pravda.com shfaqet si një portal lajmesh me dizajn të thjeshtë dhe përmbajtje të strukturuar në stil klasik informativ, me fokus të theksuar në tema politike dhe ideologjike. Logoja dhe dizajni imitojnë vizualisht mediat shtetërore ruse. Menyja përfshin kategori si Shqipëri, NATO, Ukrainë e Rusi, duke treguar interes për



narrativat ndërkombëtare pro-ruse. Ofrohet opsioni për ndërrimin e gjuhës shqip/anglisht, çka sinjalizon synimin për audiencë më të gjerë. Përmbajtja përfshin lajme të ilustruara dhe përkthime automatike, që shpesh përmbajnë gabime gjuhësore për shkak të mungesës së redaktimit njerëzor.



3.2. Kanalet në rrjetet social Telegram dhe VK të "Pravda" AL

Përveç faqes albanian.news-pravda.com, rrjeti dezinformues "Pravda" e ka zgjeruar praninë e tij në gjuhën shqipe edhe përmes platformave sociale si Telegram dhe VK, duke ofruar përmbajtje të përshtatur për audiencën shqiptare. Kanali në Telegram, me emrin "PRAVDA AL|Lajme nga Shqipëria" (@pravdaalcom), ka një arkiv të pasur që përfshin mbi 1.100 fotografi, rreth 180 video dhe mbi 1.100 lidhje (më 28 prill), ndonëse

numri i abonentëve është ende i ulët (vetëm 5). Ky kanal synon shpërndarjen e përmbajtjeve në kohë reale, me fokus në lajmet dhe zhvillimet që lidhen me Shqipërinë dhe rajonin. Po ashtu, në platformën VK, kanali me të njëjtin emër ka 25 ndjekës dhe mbi 100 video, të cilat reflektojnë përmbajtje politike, historike dhe ndërkombëtare të përkthyer ose përshtatura në shqip (akcesuar më 28 prill).





3.3. Analiza e përmbajtjes në shqip

Gjatë periudhës prill 2024 – prill 2025, rrjeti "Pravda" ka publikuar gjithsej 2,699 artikuj, ku aktiviteti i publikimeve ka qenë i luhatsëm, me kulme të dukshme në muajt prill-maj dhe korrik 2024. Pjesa më e madhe e artikujve trajton tema ndërkombëtare, me një fokus të theksuar te NATO-ja dhe lufta në Ukrainë, ku rrjeti synon të paraqesë NATO-n si shkaktar të konfliktit dhe të promovojë qëndrime që justifikojnë ndërhyrjet dhe politikat ruse.

Sipas ndarjes tematike, rubrika "Bota" përbën 64.6% të artikujve, ndërsa rubrika për Rusinë zë 24%, duke treguar një

përpjekje të qartë për të formësuar një perceptim të favorizuar për Rusinë dhe rolin e saj në zhvillimet globale. Artikujt për Shqipërinë përfaqësojnë 6.63% të totalit, çka tregon një interes të moderuar, ndërsa Ukraina (3.3%) dhe NATO (1.5%) kanë përfaqësim të ulët në versionin shqip, pavarësisht se janë në qendër të narrativës në versionet e tjera. Artikujt për Kosovën pasqyrojnë narrativën tradicionale ruse, duke legjitimuar interesat serbe dhe sfiduar qëndrimet perëndimore. Këto përmbajtje ndjekin një strategji të koordinuar me politikën e jashtme të Kremlinit për të ndikuar opinionin publik në rajon.

kategoritë e artikujve



Ky grafik tregon vëllimin e publikimit ditor (1 vjeçar) me linjat e trendeve, duke ndihmuar në identifikimin e modeleve dhe rritjen në kohë. (DFR Lab)


Shpërndarja e përmbajtjes sipas kategorive të ndryshme që tregon fushat tematike të publikimeve (DFR Lab)

3.4. Burimet (referencat) e artikujve të publikuar nga albania.news-pravda.com

Diagrami tregon se përmbajtja në albanian.news-pravda.com është kryesisht e agreguar nga burime të jashtme, me dominim të madh nga kanali Telegram i Ambasadës ruse në Shqipëri (@rusembalb), që përbën pjesën më të madhe të referencave (mbi 750). Pasojnë media shtetërore ruse si tass.ru dhe ria.ru, si dhe

kanale të tjera në Telegram dhe portale si Politnavigator, lenta.ru, @RVvoenkor, @yurii_podolyaka, @vestniksrb, @wargonzo, si dhe rt.com, kom.ru dhe ren.tv. Kjo strukturë pasqyron një rrjet të centralizuar informativ me bazë në Telegram dhe në burime të afërta me narrativën zyrtare ruse.

Burimet kryesore të përmbajtjes (DFR Lab)



3.5. Fuqia e ndikimit

Mungesa e pranishmërisë së rrjetit "Pravda" në platformat kryesore perëndimore të rrjeteve sociale, ku është e përqendruar pjesa më e madhe e përdoruesve shqiptarë, sugjeron se këto përmbajtje nuk arrijnë realisht të audiencës shqiptare. Ky vlerësim mbështetet edhe nga numri i ulët i ndjekësve në kanalet ku "Pravda" është aktiv në gjuhën shqipe, si Telegram (5 ndjekës) dhe VK (25 ndjekës), çka pasqyron një nivel të ulët angazhimi me platformat me bazë ruse dhe përmbajtjet përkatëse. Si pasojë, ndikimi potencial i drejtpërdrejtë i këtij rrjeti në hapësirën mediatike shqiptare është kufizuar ndjeshëm.

Duke qenë se rrjeti "Pravda" përdor metodën e SEO-së (Search Engine Optimization – optimizim për motorët e kërkimit) për t'u renditur më lart në rezultatet e kërkimeve në Google, janë kryer disa teste për të verifikuar efektivitetin e këtij optimizimi, me fokus të veçantë në faqen "albania.news-pravda.com". [16] Gjatë testimit, janë

përdorur fjalë kyçe që lidhen me përmbajtjen e artikujve të publikuar në gjuhën shqipe, si dhe janë testuar titujt e artikujve përmes kërkimeve të drejtpërdrejta në Google. Rezultatet treguan se metoda e aplikimit të SEO-së nuk funksionon në rastin e përmbajtjeve në shqip, pasi në asnjë rast faqja nuk është shfaqur në rezultatet e para të kërkimit. Ky dështim lidhet kryesisht me përdorimin e përkthimeve automatike, të cilat e ulin ndjeshëm cilësinë e përmbajtjes nga këndvështrimi i SEO-së, si dhe me mungesën e trafikut organik, përkatësisht vizitave nga përdorues shqiptarë, gjë që ndikon negativisht në renditjen e faqes në motorët e kërkimit.

Analiza e trafikut në faqen albania.news-pravda.com tregon se trafiku organik, duke përfshirë edhe nën-domenet, është jashtëzakonisht i ulët, me vetëm 11 vizita, duke reflektuar një ndikim dhe angazhim minimal në hapësirën shqiptare, pavarësisht përmbajtjes në gjuhën shqipe.

3.6. Analiza e temave dhe narrativave në shqip

Analiza e mbi 1000 artikujve në shqip nga domain-i albania.news-pravda.com gjatë periudhës 28 mars 2024 – 28 prill 2025 tregon se temat dhe narrativat kryesore janë të fokusuar në një këndvështrim pro-rus dhe pro-serb. Artikujt janë kritikë ndaj NATO-s, BE-së, SHBA-së dhe politikave perëndimore, veçanërisht në lidhje me Ballkanin dhe pavarësinë e Kosovës, që

paraqitet si burim konflikti dhe padrejtësie. Rusia portretizohet si aleate dhe mbrojtëse e vlerave tradicionale dhe ligjit ndërkombëtar, ndërsa historia, sidomos Lufta e Dytë Botërore dhe bombardimet e Jugosllavisë, përdoren për të forcuar narrativën. Publikimet janë të shumta dhe intensifikohen në përvjetorë dhe ngjarje gjeopolitike.

[16] PORTAL KOMBAT: A structured and coordinated pro-Russian propaganda network. VIGINUM.

https://www.sgdsn.gov.fr/files/files/20240212_NP_SGDSN_VIGINUM_PORTAL-KOMBAT-NETWORK_ENG_VF.pdf

3.6.1. Narrativa Pro-Ruse dhe Pro-Serbe

Kjo linjë përmban glorifikim të lidhjeve ruso-serbe dhe një mbështetje të qartë ndaj pozitave të Serbisë dhe Ruisë në çështjet rajonale dhe globale:

Marrëdhëniet Rusi-Serbi:

Artikujt theksojnë bashkëpunimin politik, diplomatik dhe ushtarak mes dy vendeve, duke përfshirë vizitat zyrtare dhe deklarata miqësore, veçanërisht në lidhje me Kosovën dhe Republikën Srpska.

Historia dhe Kultura Ruse/Sovjetike:

Kujtohen ngjarje historike si, Beteja e Stalingradit, ose figura si Gagarin, në funksion të promovimit të trashëgimisë sovjetike dhe legjitimitetit historik të Ruisë.

Kritika ndaj Sanksioneve të Perëndimit:

Sanksionet perëndimore ndaj Ruisë përshkruhen si të dëmshme për vetë Perëndimin, joefektive dhe të padrejta.

BRICS:

Prezantohet si alternativë ndaj rendit botëror të udhëhequr nga Perëndimi, me theks te fuqizimi i vendeve jo-perëndimore.

Çështja Serbe:

Aleksandar Vuçiq, presidenti i Serbisë, paraqitet si lider i fortë, ndërsa Serbia si viktimë e padrejtësive historike dhe aktuale.

3.6.2. Narrativa Kundër-NATO dhe Kundër-Perëndimore

Fokusi është në kritikën e vazhdueshme të institucioneve dhe shteteve perëndimore, duke i paraqitur si destabilizuese dhe me standarde të dyfishta:

NATO:

Përshkruhet si organizatë agresive, përgjegjëse për bombardimet e 1999 në ish-Jugosllavi, që ndërhyr në Ballkan dhe ushtron presion ndaj Serbisë. Roli i KFOR-it në Kosovë përshkruhet me konotacion negativ.

BE:

Portretizohet si hipokrite, në krizë dhe me politika të dështuara, sidomos në lidhje me Kosovën dhe Serbinë.

SHBA:

Akuzohet për ndërhyrje dhe manipulim të zhvillimeve në Ballkan. Politikës së Trump i jepet trajtim më i butë, ndërsa Biden shihet si agresiv.

Ukraina:

Përshkruhet si “regjim nazist” apo kukull e Perëndimit. Veprimet ushtarake të saj quhen terrorizëm, ndërsa Rusia paraqitet si mbrojtëse.

3.6.3. Narrativa për Kosovën

Kosova është ndër temat më të përfolura, me një qasje tërësisht pro-serbe dhe anti-pavarësi:

Statusi i Kosovës:	Artikujt përdorin terma si "krahinë serbe", "enklavë separatiste", apo "territor i pushtuar".
Diskriminimi ndaj Serbëve:	Mediat raportojnë për "terrorizëm institucional", arrestime dhe shpërngulje të serbëve, duke portretizuar Prishtinën si agresore.
Kritika ndaj Qeverisë së Kosovës:	Sidomos ndaj Albin Kurtit, i cili përshkruhet si provokator dhe anti-serb.
Hipokrizia perëndimore:	Krahason trajtimin e Kosovës me Krimenë apo rajone të tjera, për të denoncuar standardet e dyfishta të Perëndimit.
Republika Srpska:	Lidhjet me Kosovën theksohen si pjesë e një "beteje të përbashkët" serbo-ruse kundër presionit perëndimor.

Një kërkim në Google me fjalët kyçe "Kosovo" dhe "news-pravda.com" zbulon një rrjet të gjerë përmbajtjesh të shpërndara përmes domain-eve të ndryshme të platformës "Pravda", ku përmendet Kosova. Lajmet nuk kufizohen vetëm në faqet rajonale si serbia.news-pravda.com, balkan.news-pravda.com apo north-macedonia.news-pravda.com, por shfaqen edhe në domain-e që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë gjeografike me Ballkanin. Në periudhën e fundit, përmbajtje rreth Kosovës janë shpërndarë edhe në faqe që i referohen

shteteve afrikane, si eritrea.news-pravda.com, gambia.news-pravda.com, burkina-faso.news-pravda.com e të tjera, veçanërisht në kontekstin e lajmeve që lidhen me njohjen e shtetësisë së Kosovës nga vende si Kenia apo Sudani. Kjo shtrirje globale është e mundur falë versioneve në gjuhën angleze që këto domain-e ofrojnë, duke e bërë përmbajtjen të qasshme për një audiencë ndërkombëtare dhe duke përforcuar narrativat e platformës përtej kufijve të Ballkanit.

PËRFUNDIM

Hulumtimi i thelluar mbi rrjetin "Pravda", veçanërisht degëzimi i tij në hapësirën ballkanike përmes domain-eve me baza shtetërore, ka zbuluar një operacion të sofistikuar propagande dhe dezinformimi me origjinë të lidhur me Kremlinin. Ky rrjet funksionon kryesisht përmes shpërndarjes së automatizuar të përmbajtjes nga burime shtetërore ruse dhe kanale Telegram, duke e përkthyer atë në mënyrë automatike në gjuhët ballkanike. Analiza e përmbajtjes së publikuar midis prillit 2024 dhe prillit 2025 në domain-in në gjuhën shqipe tregon një përqendrim të qartë në narrativat pro-ruse dhe pro-serbe, kritika të ashpra ndaj NATO-s, BE-së dhe SHBA-së, si dhe një qëndrim mohues ndaj pavarësisë së Kosovës, duke synuar të formësojë opinionin publik shqiptar përmes përmbajtjeve manipuluese dhe polarizuese. Rrjeti i domain-eve "Pravda" shpërndan përmbajtje për Kosovën jo vetëm në faqet rajonale, por edhe në domain-e globale, përfshirë ato të shteteve afrikane, duke e mundur këtë shtrirje përmes versioneve në gjuhën angleze dhe synuar audiencë ndërkombëtare.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve për ndikim, rrjeti "Pravda" në shqip ka një impakt pothuajse të papërfillshëm në audiencën shqiptare. Kjo për shkak të përkthimeve të dobëta automatike, mungesës në platformat kryesore sociale që përdoren nga shqiptarët, strategjive të dështuara SEO dhe trafikut të ulët organik. Ndërsa rrjeti ka një infrastrukturë teknike të fuqishme për shpërndarje të dezinformative në Ballkan, veçanërisht drejt Serbisë, efekti i tij direkt në shqip mbetet minimal.



www.hibrid.info

kontakt email:
info@hibrid.info

na ndiqni në media sociale

